



INTERNEWS KOSOVA

Mensa e studentëve, kati i parë
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës

Tel: (+383) 38 224498
Fax: (+383) 38 224498
Web: www.internewskosova.org
E-mail: info@internewskosova.org

Kodi i etikës dhe mirësjelljes së Internews Kosova

Neni 1

Ky dokument rregullon vlerat dhe standardet e organizatës, anëtarëve themelues, anëtarëve të Kuvendit dhe të gjithë stafit të angazhuar në Internews Kosova me orar të plotë, të shkurtuar, për periudha të shkurta (kontratë mbi vepër), praktikantëve dhe të gjithë vullnetarëve.

Etika

Neni 2

Vlerat e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies do të udhëheqin punën tonë. Prandaj, ne do të kujdesemi që:

- Të jemi të hapur, të ndershëm dhe të përgjegjshëm në marrëdhëniet tona me të gjithë ata me të cilët punojmë dhe me njëri-tjetrin;
- Të përpilojmë raporte të sakta dhe me kohë të aktiviteteve tona ndaj dhe për palët me të cilat punojmë;
- Të jemi të sigurtë dhe të paanshëm në trajtimin e palëve;
- T'u japim përparësi interesave të përbashkëta të popujve të Ballkanit;
- Të themi qëndrimin tonë sa herë lind ndonjë konflikt interesi;
- Të kërkojmë dhe të ushtrojmë përgjegjësi, llogaridhënie dhe besueshmëri;
- Të mos keqadministrojmë pasuritë ose të abuzojmë me privilegje;
- Të mos komprometojmë integritetin tonë personal dhe të organizatës apo të diskreditojmë Internews Kosova.

Neni 3

Do të mbështeten vlerat e pavarësisë, guximit dhe përgjegjësisë. Prandaj, ne do:

- Të përmbahemi nga çfarëdo përfshirje në procese politike, çështje pune dhe konteste në mes palëve të treta që shkon përtej qëllimeve të gazetarisë së përgjegjshme hulumtuese;
- Të jemi demokratik, të mos i takojmë asnjë partie politike apo grupi tjetër që mund të jetë në konflikt me punën tonë;
- Të pranojmë vetëm fonde që nuk e komprometojnë mundësinë tonë për të adresuar lirisht çështje në mënyrë të plotë dhe objektive, dhe që nuk dëmtojnë pavarësinë dhe identitetin tonë;
- Të ruajmë pavarësinë tonë dhe t'i rezistojmë kushtëzimeve që mund të komprometojnë parimet tona;
- Të promovojmë kulturën e vetë-vlerësimit dhe të kryejmë vlerësime të rregullta të performancës për të monitoruar dhe vlerësuar punën tonë;



INTERNEWS KOSOVA

Mensa e studentëve, kati i parë
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës

Tel: (+383) 38 224498
Fax: (+383) 38 224498
Web: www.internewskosova.org
E-mail: info@internewskosova.org

- Të jemi të hapur për ndryshim konstruktiv dhe përmirësim të vazhdueshëm;
- Të promovojmë përdorimin e burimeve lokale dhe kontributet e komunitetit nga diaspora.

Neni 4

Do të përpiqemi të arrijmë të kemi përfitim dhe ndikim të plotë për të mirë dhe ndryshim përmes të gjitha programeve dhe projekteve tona. Prandaj do:

- Të sigurojmë qasje të barabartë për të gjithë në përfitimet që sjellin projektet tona, pavarësisht nga mosha, gjinia, kombësia, feja, etnia, apo përkatësia politike;
- Të përmirësojmë vazhdimisht cilësinë e projekteve tona dhe të përpiqemi t'i përmbushim nevojat që kërkon koha;
- Të bazojmë pozicionin tonë në analiza objektive e profesionale dhe në hulumtime të standardeve të larta;
- Të promovojmë angazhimin e publikut dhe edukimin, ngritjen e kapaciteteve për përfituesit duke i bërë të vetëdijshëm për të drejtat dhe detyrimet e tyre;
- Të planifikojmë, dizajnojmë, zbatojmë, monitorojmë dhe vlerësojmë programet dhe projektet tona duke përfshirë palët e interesuara;
- Të nxisim projekte të qëndrueshme me një ndjenjë të pronësisë në mesin e përfituesve;
- Të bëjmë që veprimet tona të sjellin dobi për komunitetin dhe të jenë relevante ndaj nevojave dhe prioriteteve të tyre.

Neni 5

Do të mbështetën vlerat e qeverisjes së mirë dhe demokracisë së brendshme. Prandaj ne do të:

- Bazojmë të gjitha vendimet tona në fakte dhe logjikë;
- Shmangim dominimin dhe burokracinë, duke krijuar kështu një ambient të favorshëm për demokracinë e brendshme;
- Respektojmë marrëveshjet dhe politikat e përbashkëta me organizatat e Kosovës;
- Zhvillojmë politika, procedura dhe sisteme efektive dhe relevante për organizatën;
- Të lejojmë palët e interesuara që të kenë qasje në raportet tona të progreseve të projekteve dhe deklaratave financiare;
- T'i bindemi statutit tonë të shkruar dhe akteve nën-ligjore që definojnë misionin, objektivat dhe strukturën organizative të I/KS;
- Të zbatojmë kulturën e marrëveshjeve me shkrim për të gjitha çështjet e rëndësishme administrative, operacionale dhe financiare;



INTERNEWS KOSOVA

Mensa e studentëve, kati i parë
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës

Tel: (+383) 38 224498
Fax: (+383) 38 224498
Web: www.internewskosova.org
E-mail: info@internewskosova.org

- Të mirëmbajmë procedura adekuate financiare dhe sisteme të kontabilitetit për të rregulluar praktikat tona financiare;
- Të nxisim rritjen e kapaciteteve të brendshme dhe trajnimin;
- Të paraqesim imazhin tonë publik në mënyrë profesionale.

Neni 6

Do të ruhet një frymë respekti, solidariteti, pjesëmarrjeje dhe bashkëpunimi.. Prandaj, ne do:

- Të vlerësojmë kulturën, traditën, vlerat, dinjitetin dhe identitetin e anëtarëve, stafit dhe komuniteteve tona;
- Të respektojmë politikat kundër ngacmimit dhe diskriminimit;
- Të ruajmë respektin reciprok dhe konsideratën mes anëtarëve dhe stafit;
- Të komunikojmë dhe konsultojmë njëri tjetrin haptazi dhe kolegialisht në një mënyrë që ndihmon secilin prej nesh të përmbushim detyrat dhe përgjegjësitë tona me besnikëri dhe efikasitet;
- Të përpiqemi për përfaqësim të balancuar dhe të larmishëm në organet tona qeverisëse.
- Të shkëmbejmë ide dhe përvoja me anëtarët dhe partnerët e tjerë;
- Të inkurajojmë shkëmbimin e informacionit dhe burimeve;
- Të inkurajojmë punën në ekip, një frymë bashkëpunimi dhe reciprociteti mes anëtarëve, stafit dhe aktorëve;
- Të promovojmë rritjen e kapaciteteve mes stafit;
- Të zgjidhim konfliktet tona miqësisht dhe të shmangim konfrontime të hapura;
- Të mësojmë nga njëri-tjetri dhe të ruajmë kulturën dinamike.

Neni 7

Ndjenja e drejtësisë duhet ta udhëheqë punën tonë. Prandaj ne do:

- Të ushtrojmë dhe promovojmë drejtësi dhe barazi në të gjitha aktivitetet tona, kur kemi të bëjmë me komunitetet, partnerët dhe publikun në përgjithësi;
- Të drejtohem nga parimet e Deklaratës Universale të të drejtave të njeriut;
- Të nderojmë dhe promovojmë të drejtat e atyre që janë në disavantazh;
- Të respektojmë dhe të inkurajojmë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore.



INTERNEWS KOSOVA

Mensa e studentëve, kati i parë
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës

Tel: (+383) 38 224498
Fax: (+383) 38 224498
Web: www.internewskosova.org
E-mail: info@internewskosova.org

Kodi i mirësjelljes

Neni 8

Interesat e Internews Kosova, duhet të mbrohen dhe imazhi i tij duhet të ruhet gjatë gjithë kohës.

Neni 9

Anëtarët e Internews Kosova duhet t'i kushtojnë kujdes dhe vëmendje nevojave dhe interesave të përfituesve të tij. Çdo informacion mbi ta duhet të mbahet konfidencial sa herë që kërkohet.

Neni 10

Të gjitha të dhënat e punës së I/KS-it konsiderohen konfidenciale, përveç raporteve të përpiluara veçanërisht për publik ose palë të treta ose në rast kur kjo kërkohet nga autoritetet ligjore apo palët kontraktuese. Për këtë qëllim, cdo person në marrëdhënie kontraktuale me I/KS, nënshkruan Deklaratën e Konfidencialitetit, që është pjesë integrale e Kodit (Shtojca 1).

Informacionet për I/KS-in mund të bëhen publike vetëm nga personat e autorizuar.

Asnjë informatë e rreme nuk duhet të përhapet në lidhje me I/KS Kosovën apo informacion që ka për qëllim dëmtimin e interesave apo imazhin e I/KS Kosovës. Për këtë qëllim, cdo person në marrëdhënie kontraktuale me I/KS, nënshkruan Deklaratën e Parimeve (Shtojca 2).

Stafi i I/KS Kosovës nuk duhet të përdorë informacione të punës apo konfidenciale për interes personal.

Neni 11

Punët e I/KS Kosovës nuk duhet të diskutohen tjetërkund përveç në forumet e krijuara posaçërisht dhe autorizuar nga menaxhmenti për këtë qëllim sic janë takimet e redaksisë, departamenteve të ndryshme, diskutimet direkte me menaxherët e linjës apo drejtorin e organizatës.

Neni 12

Stafi duhet të ruajë qasje profesionale gjatë kontakteve me të gjithë përfituesit dhe palët e treta.

Çdo marrëdhënie personale me stafin e I/KS Kosovës, përfituesve ose palëve tjera të treta relevante që shkon përtej marrëdhënieve profesionale (raportet familjare, miqësore dhe intime) duhet të deklarohet, për tu mbrojtur nga konflikti i interesit.

Marrëdhëniet personale në mes të stafit që përtej marrëdhënieve profesionale (raportet familjare, miqësore dhe intime) e sidomos në rastet kur një nga



INTERNEWS KOSOVA

Mensa e studentëve, kati i parë
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës

Tel: (+383) 38 224498
Fax: (+383) 38 224498
Web: www.internewskosova.org
E-mail: info@internewskosova.org

personat e përfshirë është në pozitë menaxheriale apo me influencë në organizatë konsiderohen si të papërshtatshme.

Marrëdhënie të tilla personale përfundimisht mund të shkaktojnë vështirësi në vendin e punës dhe mund të krijojnë konflikte.

Në rast që një marrëdhënie e tillë ekziston apo zhvillohet gjatë kohës së punës në Internews Kosova, ajo duhet të bëhet publike.

Në raste të tilla, të dy personat e përfshirë duhet të njoftojnë Burimet Njerëzore dhe Menaxherin e linjës brenda 7 ditëve të punës. Për këtë qëllim, çdo person në marrëdhënie kontraktuale me Internews Kosova, nënshkruan Deklaratën e Raportit Personal sapo të bëhet publik (Shtojca 3).

Drejtori i I/KS vendos në rast se një nga personat e përfshirë në raport personal që shkojnë përtej marrëdhënieve profesionale (raportet familjare, miqësore dhe intime) duhet të risistemohet brenda organizatës. Në raste kur një marrëdhënie e tillë fillon të krijojë probleme, atëherë Drejtori i Internews Kosova mund t'i kërkojë njërit nga ata që të largohet me marrëveshje në mes tyre.

Neni 13

Kritikat ndaj punës së organizatave të tjera në prani të palëve të treta duhet të shmangen sa herë është e mundur. Kritikat e tilla nuk duhet bërë me qëllim të keq.

Neni 14

Stafi i Internews Kosova duhet të shërbejë gjithë kohën si shembull pozitiv gjatë gjithë kohës për kolegët dhe vartësit e tyre si dhe për përfituesit dhe palët e treta relevante.

Neni 15

Përgjegjësia e Internews Kosova është në zinxhirin komandues, i cili duhet respektuar gjatë gjithë kohës.

Neni 16

Stafi duhet të sigurojë që ky kod i mirësjelljes të pranohet nga të gjithë bashkëpunëtorët, konsulentët, etj që janë të përfshirë në punën e Internews Kosova.

Personat në pozita menaxhuese duhet të trajtojnë të gjithë stafin në mënyrë të barabartë dhe duhet të shpërndajnë detyrat në bazë të përshkrimit të punës dhe kontratave, dhe duke u bazuar në rezultatet e arritura. Stafi duhet lavdëruar dhe shpërblyer për suksesin, por edhe duhet t'i tërhiqet vërejtja për gabimet, brenda kornizës procedurale.



INTERNEWS KOSOVA

Mensa e studentëve, kati i parë
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës

Tel: (+383) 38 224498
Fax: (+383) 38 224498
Web: www.internewskosova.org
E-mail: info@internewskosova.org

Neni 17

Stafi duhet të pranojë vetëm detyrat për të cilat janë plotësisht të aftë dhe të kualifikuar për t'i përmbushur.

I gjithë stafi duhet të respektojë orarin e punës; të përmbushë detyrat ashtu si di më së miri; të prodhojë raporte adekuate të punës së tyre; të respektojë udhëzimet që kanë të bëjnë me punën e tyre dhe të marrin të gjithë hapat e mundshëm për të përmirësuar veten profesionalisht.

Neni 18

I gjithë stafi është i detyruar të jetë i kujdesshëm ndaj hapësirave, pajisjeve dhe materialeve të Internews Kosova, duke i kushtuar vëmendje të veçantë trajtimit të pajisjeve teknike.

Neni 19

I gjithë stafi duhet t'i përgjigjet telefonatave, e-mailave dhe faksit me çdo kusht. Të gjitha format e komunikimit me shkrim dhe prezantimet publike duhet të mbajnë versionin e aprovuar të logos së Internews Kosova.

Neni 20

Stafi nuk duhet të mbjellë shpresa të paarsyeshme në mesin e të punësuarve të Internews Kosova, përfituesve, donatorëve ose palëve tjera të treta relevante.

Neni 21

Stafi duhet të refuzojë çdo ofertë për kompensim ose përfitim financiar nga përfituesit ose palët e treta që nuk është pjesë integrale e buxhetit apo kontratës me të cilën është pajtuar anëtari përgjegjës i stafit.

Mos diskriminimi

Neni 22

Kjo politikë rregullon ruajtjen e një mjedisi të sigurt pune nga të gjitha format e diskriminimit. Të gjithë aplikantët për pozita të hapura të punës do të kenë mundësi të barabarta punësimi dhe të gjithë punonjësit do të kenë mundësi të barabarta për promovim në fushat e tyre përkatëse të punës.

Neni 23

Internews Kosova ofron mundësi të barabarta për të gjithë të punësuarit e saj dhe aplikantët, pavarësisht nga raca, ngjyra e lëkurës, gjinia, feja, mosha, gjendja martesore, paaftësitë, statusi i veteranit apo përkatësisë kombëtare në: rekrutim, punësim, emërim, transferim, ngritje në detyrë, ulje në detyrë, mundësi trajnimi, pushim nga puna, ofrim të shërbimeve, pagë, vlerësim, përfitim, kompensim dhe masa tjera të stafit.



INTERNEWS KOSOVA

Mensa e studentëve, kati i parë
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës

Tel: (+383) 38 224498
Fax: (+383) 38 224498
Web: www.internewskosova.org
E-mail: info@internewskosova.org

Neni 24

Internews Kosova nuk duhet të diskriminojë asnjë punonjës ose kandidat për shkak të paaftësisë së tij / saj, pavarësisht pozitës për të cilën ka aplikuar.

Neni 25

Çdo person, punonjës ose kandidat i cili beson se ka qenë i diskriminuar duhet të ankohet te Zyrtari për Burime Njerëzore. Ankesat mund të dorëzohen në formë të shkruar ose personalisht dhe mund të jenë anonime. Ankuesi do të njoftohet për çdo hetim apo masa të ndërmarra për zgjedhjen e problemit.

Neni 26

Internews Kosova nuk do të tolerojë asnjë lloj diskriminimi dhe do të ndërmarrë masat e nevojshme, përfshirë edhe pushimin nga puna, ndaj çdo personi që vërtetohet që ka shkelur këtë politikë.

Neni 27

Internews Kosova nuk do të diskriminojë ndonjë person që reagon ose akuzon për punësim të paligjshëm ose diskriminim, dëshmon, ndihmon apo merr pjesë në çfarëdo forme të procedurës hetimore, apo seancë që ka të bëjë me procedurat e punësimit.

Politikat ndaj ngacmimit seksual

Neni 28

Ngacmimi seksual nuk do të tolerohet në INTERNEWS KOSOVA.

Për nevojat e këtyre politikave, "ngacmimi" është përkufizuar si sjellje vizuale, gojore, ose fizike që për efekt apo qëllim që në mënyrë të paarsyeshme të ndërhyjë në performancën e punës së një individi ose krijon mjedis të punës kërcënues, armiqësor ose ofendues.

"Ngacmimi seksual", është përkufizuar si çdo afrim i padëshirueshëm seksual, kërkesa për favore seksuale, ose sjellje të tjera verbale apo fizike të natyrës seksuale me të njëjtin qëllim ose efekt. Kjo mund të përfshijë por nuk kufizohet në:

- Emrat abuziv, fyerjet, shakatë e këqija apo komentet diskredituese, ngacmimet seksuale të padëshiruara, ftesat apo komentet;
- Shikimet sugjестive, gjeste seksuale, shfaqja e objekteve ose fotografive përçmuese dhe/ose seksualisht sugjестive;
- Sulmet, pengimi apo bllokimi i lëvizjes, prekjet apo kontaktet e padëshiruara fizike drejt seksit të një individi ose ndonjë statusi tjetër mbrojtur;
- Kërcënimet dhe kërkesat për t'iu nënshtruar kërkesave seksuale si kusht për vazhdim të punësimit, ose për të shmangur humbje tjera, ofertat, ose



INTERNEWS KOSOVA

Mensa e studentëve, kati i parë
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës

Tel: (+383) 38 224498
Fax: (+383) 38 224498
Web: www.internewskosova.org
E-mail: info@internewskosova.org

beneficione tjera nga punësimi në këmbim të favoreve seksuale, ose kërcënimet për ndëshkim pas refuzimit të ngacmimeve seksuale; dhe

- Hakmarrje nëse raportohet ose kërcënohet të raportohet ngacmimi.
- Joshjet seksuale të një zyrtari i cili është në një pozitë për të ndikuar në kushtet e karrierës apo punësimin e atij që i drejtohen joshjet e tilla do të rezultojë me ndërprerje të menjëhershme të punësimin, pasuar nga ndjekja e procedurave të duhura hetimore.

Neni 29

INTERNEWS KOSOVA Kosova do të mbrojë stafin e saj sa më shumë të jetë e mundur nga ngacmimet që vijnë nga palët e treta.

Neni 30

Çdo pjesëtar i stafit i cili mendon se ai/ajo ka qenë i/e ngacmuar ose diskriminuar në përputhje me përkufizimet e këtij kodi inkurajohet që menjëherë të marrë masa për të zgjidhur problemin sa më parë që është e mundur, dhe të informojë shkelësin në mënyrë direkte dhe të vendosur që sjelljet e tij ose saj janë të pavend. Nëse qasja joformale nuk realizohet apo rezulton duke mos e zgjedhur problemin, stafi i prekur mund të kontaktojë Zyrtarin e Burimeve Njerëzore, ose menaxherin e tij/saj të linjës, për të ndërmarrë masa konkrete.

Në raste të tilla, Zyrtari për Burime Njerëzore, së pari tenton të adresojë problemin menjëherë me palën dhe i tërheq vëmendjen shkelësit të supozuar që sjelljet e tilla janë të pavenda dhe duhet të ndalen menjëherë. Kur as kjo nuk ka efekt dhe ankuesi pretendon që shkelja po vazhdon, atëherë, formohet një komision Ad Hoc për hetime që caktohet për këtë qëllim e që do të hetojë çështjen pa u vonuar. Ky komision duhet të përpilojë një raport të hollësishëm me rekomandime të nevojshme, duke përfshirë masat disiplinore të cilat mund të variojnë nga paralajmërimi verbal deri te shkarkimi në rastet e shkeljeve të rënda ose të përsëritura.

Nëse ankesa është e rremë ose e bërë për qëllime të këqija, komisioni mund të mbyllë procedurat menjëherë, dhe rrjedhimisht të hapë procedurë kundër individit që bën ankesë bazuar mbi dëshmi të rreme.

Nëse stafi është i bindur se ankesa e tij apo saj nuk është trajtuar siç duhet, ai apo ajo mund t'i shkruajë kryetarit të Kuvendit të INTERNEWS KOSOVA.

Neni 31

Çdo i punësuar i cili ngacmon tjetrin do t'i nënshtrohet procedurave disiplinore, duke përfshirë paralajmërimin, suspendimin ose shkarkimin e plotë nga puna. Të gjithë ngacmuesit janë përgjegjës para ligjit.



INTERNEWS KOSOVA

Mensa e studentëve, kati i parë
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës

Tel: (+383) 38 224498
Fax: (+383) 38 224498
Web: www.internewskosova.org
E-mail: info@internewskosova.org

Neni 32

Çdo menaxher është përgjegjës për zbatimin e këtyre politikave në departamentin e tij/saj.

Politikat mbi Konfliktin e Interesit

Neni 33

Çdo person i lidhur me INTERNEWS KOSOVA duhet të shmangë ose të menaxhojë çdo konflikt të interesit të vërtetë ose të perceptuar si të tillë (inter alia, duke e hequr nga çdo vendimmarrje apo votim mbi çështjet që janë subjekt i një konflikt të mundshëm të interesit), dhe haptazi të deklarojnë ndonjë konflikt potencial ose real të interesit, i cili lind si rezultat i lidhjes së tij/saj me INTERNEWS KOSOVA Kosovën.

Anëtarët e Kuvendit dhe stafi janë të detyruar të deklarojnë lidhjet e tyre personale ose profesionale me ndonjë nga organizatat ose kompanitë me të cilat INTERNEWS KOSOVA zhvillon biznes (Shtojca 3).

Neni 34

INTERNEWS KOSOVA nuk mund të blejë mallra apo shërbime nga kompanitë ku anëtarët e Kuvendit të INTERNEWS KOSOVA ose të punësuarit apo familjarët e tyre janë pronarë ose bashkë-pronarë. Anëtarët e familjes përfshijnë prindërit, vëllezërit, motrat, bashkëshortët dhe fëmijët.

Neni 35

Anëtarët e kuvendit nga INTERNEWS KOSOVA Kosova nuk lejohen të përfitojnë financiarisht apo materialisht nga angazhimi i tyre, përveç rimbursimit të shpenzimeve që ndërlidhen me aktivitetet e angazhimit të tyre. Këto kosto mund të përfshijnë udhëtimin, drekat, thirrjet telefonike, dhe faksi.

Neni 36

Mosrespektimi i politikave të lartcekura mbi konfliktin e interesit do të rezultojë në masa disiplinore për anëtarët e Kuvendit dhe stafit. Çdo konflikt i mundshëm i interesit duhet të raportohet dhe të përcaktohen masat e duhura disiplinore të marra ndaj anëtarit përkatës të Kuvendit apo stafit.

Neni 37

Konfliktet e mundshme të interesit duhet të identifikohen dhe të deklarohen nga personi i implikuar në ndonjë konflikt potencial, ose nga anëtarët e tjerë të INTERNEWS KOSOVA-it, sapo të kenë mësuar për ndonjë konflikt të tillë të interesit.



INTERNEWS KOSOVA

Mensa e studentëve, kati i parë
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës

Tel: (+383) 38 224498
Fax: (+383) 38 224498
Web: www.internewskosova.org
E-mail: info@internewskosova.org

Deklarimi ose raportimi i tillë duhet bërë te Burimet Njerëzore të INTERNEWS KOSOVA-it, menaxheri i linjës ose drejtori.

Vlerësimi i një konflikti të mundshëm të interesit duhet të bëhet nga Drejtori ose Kuvendi i INTERNEWS KOSOVA. Vlerësimi mund të përcaktojë mungesën e konfliktit të interesit, ose mund të çojë në përfundimin se (i) se personi përkatës nuk duhet të vazhdojë tutje ose (ii) ai/ajo duhet të tërhiqen nga pjesëmarrja në vendimmarrje të INTERNEWS KOSOVA-it apo çfarëdo organizate tjetër anëtare të saj që lidhet me çështjen e konfliktit.

Drejtori dhe menaxherët e INTERNEWS KOSOVA-it janë përgjegjës të sigurojnë që të gjithë personat që lidhen me aktivitetet e INTERNEWS KOSOVA janë të vetëdijshëm për politikën dhe procedurat që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit.

Unë, i/e nënshkruari/a. _____ (shkruaj emrin dhe mbiemrin e plotë), përmes këtij nënshkrimi konfirmoj që kam lexuar dhe kuptuar Kodin e etikës dhe mirësjelljes së INTERNEWS KOSOVA-it dhe do t'i kryej detyrat e mia në përputhje me këto rregulla dhe shkelja e këtyre rregullave paraqet bazë për shkarkimin tim të menjëhershëm.

Burimet Njerëzore

Data:

Punonjësi

Data: